



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AA.nr. 15/2025**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS** në kolegjin e gjyqtarëve: Nenad Laziq, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija dhe Beshir Islami, anëtarë të kolegjit, në procedurë sipas ankesës së Organizatës joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Koalicioni për Familjen me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Rregullores për sjelljen e subjekteve politike, mbështetësve të tyre dhe kandidatëve gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 09.02.2025, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik parashtruar kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A. nr. 138/25 të datës 25.01.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 31.01.2025, nxjerr këtë:

### A K T V E N D I M

Hudhet poshtë si e palejueshme ankesa e subjektit politik Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, parashtruar Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A. 138/25 të datës 25.01.2025.

### A r s y e t i m

Me vendim të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe parashtresa A. nr. 138/95 të datës 25.01.2005, në pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar ankesa e organizatës joqeveritare CEI Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë A.nr. 138/25 i datës 23.02.2025

Në pikën II të dispozitivit, subjektit politik Koalicioni për Familjen me seli në Prishtinë, për shkak së shkeljes së Rregullorës së sjelljes të subjekteve politike, përkrahësve dhe kandidatëve të tyre, i është shqiptuar gjobë në shumën prej 5.000.00 (pesë mijë euro).

Në pikën II të dispozitivit, obligohet subjekti politik Koalicioni për Familjen me seli në Prishtinë që gjobën e shqiptuar në pikën II të dispozitivit ta paguaj në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

Kundër aktvendimit të lartpërmendur, subjekti politik Koalicioni për Familjen me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij, sepse, siç thuhet në ankesë, vendimi është marrë në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe ligjet ndërkombëtare dhe paraqet shkelje të lirisë së shprehjes, duke propozuar që të aprovoj ankesën e tyre si të bazuar, të anulohet dënimin e shqiptuar ndaj Koalicionit për Familjen, si dhe të njohë deklaratat e koalicionit si shprehje të bindjeve politike, në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për të konfirmuar rëndësinë e lirisë së shprehjes në debatet demokratike.

Në përgjigjen ndaj ankesës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës ka theksuar se ankesa nuk është e lejuar dhe ka propozuar që e njëjta si e tillë të hedhet poshtë si e pabazuar.

Pas analizës së shkresave të lëndës dhe vlerësimit të lejueshmërisë së ankesës, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se:

Ankesa e subjektit politik Koalicioni për Familjen me seli në Prishtinë ushtruar kundër Vendimit të Panelit (PZAP) A.nr.138/25 i datës 25.01.2025 nuk lejohet.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më 23.01.2025 PZAP ka pranuar ankesën e organizatës joqeveritare CEI Kosova dhe Dyberizim me seli në Prishtinë, ushtruar kundër subjektit politik Koalicioni për Familjen me seli në Prishtinë, me të cilën ankesë pretendohet se kandidatët e këtij subjekti politik më 22.01.2025 në ora 23:54 me një postim në faqen e Facebook-ut, kanë bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet, kanë shkelur barazinë e qytetarëve të Kosovës dhe kanë promovuar mënyrën diskriminuese të shprehurit, si dhe kanë kërcënuar lirinë e zgjedhjes. PZAP ka dërguar ankesën A.nr.138/25 për përgjigje subjektit politik Koalicioni për Familjen, por i njëjti nuk është përgjigjur në ankesë. Pas kësaj, PZAP vendosi në mënyrën e paraqitur më lartë.

Gjykata Supreme e Kosovës, gjatë ekzaminimit të ankesës nga aspekti i pranueshmërisë të së njëjtës, ka gjetur se ankesa nuk është lejuar, për arsyet si në vijim:

Neni 118 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në paragrafin IV, përcakton: “ Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAPja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës”.

Në kuptim të dispozitës së lartpërmendur të ligjit, meqë gjoba e shqiptuar nuk e kalon kufirin e paraparë me ligj, Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi poshtë atë si të palejueshëm, dhe vendosi si në dispozitiv.

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

**A.nr.15/2025, 31.01.2025.**

**Kryetar i kolegjit, gjyqtar**

**Nenad Laziq**

